

Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Dhjetor 2020

Tiranë, më 12 Janar 2021: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Dhjetor 2020, arriti 108,2 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2020 është 1,1 %, i njëjtë si një vit më parë. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2020, krahasuar me Nëntor 2020 është 0,3 %.

Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2020 është 1,6 % nga 1,4 % që ishte në vitin 2019.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit, Dhjetor 2020 (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Dhjetor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,95 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,24 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,03 pikë secili. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,31 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje.

Për publikim 12/01/2021

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor, Dhjetor 2020 (p.p)



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Dhjetor 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,5 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1,2 % secili, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,9 %, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,7 % secili, “Komunikimi” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,5 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 4,9 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0,6 % dhe “Shëndeti” me

0,2 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 5,9 %, pasuar nga nëngrupet “vajra dhe yndyrna” me 4,5 %, “zarzavate përfshirë patatet” me 3,9 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata, dhe ëmbëlsira” me 2,2 % , “peshk” me 2,1 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 0,7 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Transporti” me 0,2 % secili, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Veshje dhe këpucë” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,1 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0,2 %, pasuar nga grupet “Komunikimi” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Dhjetor 2020

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20	11-20	12-20
	Gjithsej	100	107,1	109,1	109,5	110,2	109,7	108,8	108,1	107,6	107,8	108,2	108,5	107,9	108,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,3	113,4	118,4	119,5	121,7	120,5	118,0	116,3	114,7	115,2	116,4	117,1	115,6	116,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,4	104,6	105,2	105,3	105,5	105,3	105,4	105,4	105,5	105,6	105,3	105,2	105,5	105,6
3	Veshje dhe këpucë	3,6	99,7	99,6	99,4	98,9	98,9	98,3	98,6	98,6	98,3	98,4	98,6	99,0	99,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	105,4	106,8	106,8	106,8	106,7	106,8	106,6	106,5	106,6	106,7	106,8	106,6	106,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,4	101,4	101,3	101,3	101,5	102,6	102,4	102,4	102,2	102,7	102,3	102,5	102,4	102,6
6	Shëndeti	3,5	99,4	99,2	99,1	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3	99,2	99,1	99,1	99,1
7	Transporti	6,3	102,8	102,7	102,5	100,3	98,6	97,9	97,8	97,9	98,4	98,2	97,8	97,5	97,7
8	Komunikimi	3,0	101,2	101,0	101,0	100,9	100,9	101,7	101,7	101,7	101,7	101,7	101,7	101,8	101,7
9	Argëtim dhe kulturë	2,4	107,3	106,8	107,5	107,5	108,4	108,0	108,8	107,9	107,9	107,9	107,7	108,1	107,9
10	Shërbimi arsimor	2,9	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,2	102,2	102,2	102,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,9	102,5	102,7	102,8	102,8	102,9	102,8	102,8	102,9	102,9	102,9	103,2	103,2	103,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	6,3	103,9	103,9	104,0	103,9	103,8	103,9	104,0	104,3	104,3	104,7	104,7	104,7	104,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, Dhjetor 2020

%

Kodi	Grupet	12-19/12-18	01-20/01-19	02-20/02-19	03-20/03-19	04-20/04-19	05-20/05-19	06-20/06-19	07-20/07-19	08-20/08-19	09-20/09-19	10-20/10-19	11-20/11-19	12-20/12-19
	Gjithsej	1,1	1,5	1,2	2,1	1,9	2,1	1,8	1,4	1,3	1,5	2,0	1,6	1,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,6	2,4	1,9	4,6	4,3	4,9	4,1	3,1	3,1	3,8	4,9	3,9	2,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,2	0,5	0,7	0,8	0,6	0,6	0,6	0,7	0,6	0,4	0,3	0,6	0,9
3	Veshje dhe këpucë	-0,2	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,7	-0,5	-0,2	-0,2	-0,7	-0,8	-0,6	-0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	1,5	1,4	1,7	1,3	1,4	1,4	1,4	1,5	1,5	1,5	1,3	1,2
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,2	1,2	0,8	0,9	1,9	1,9	2,0	1,8	1,9	1,3	1,5	1,2	1,2
6	Shëndeti	-0,4	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,6	-0,6	-0,2	-0,2	-0,4	-0,4	-0,3	-0,2
7	Transporti	0,2	1,5	1,2	-1,5	-3,1	-3,7	-4,0	-4,8	-5,8	-4,6	-4,3	-4,6	-4,9
8	Komunikimi	-0,1	-0,3	-0,3	-0,4	-0,3	0,4	0,4	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5
9	Argëtim dhe kulturë	2,2	2,3	2,4	2,4	3,8	2,7	2,9	1,4	0,0	-0,4	-0,3	0,9	0,5
10	Shërbimi arsimor	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,6	0,9	0,8	0,7	0,8	0,7	0,5	0,5	0,6	0,6	0,8	0,7	0,7
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,1	0,3	0,1	0,0	0,3	0,3	0,6	0,6	0,9	0,9	0,9	0,7

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, Dhjetor 2020

%

Kodi	Grupet	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20	11-20	12-20
	Gjithsej	0,8	1,9	0,4	0,6	-0,4	-0,8	-0,6	-0,5	0,2	0,4	0,2	-0,5	0,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,0	4,4	1,0	1,8	-1,0	-2,1	-1,5	-1,3	0,4	1,0	0,6	-1,3	0,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	-0,2	0,6	0,1	0,1	-0,2	0,1	0,1	0,1	0,1	-0,3	-0,1	0,3	0,1
3	Veshje dhe këpucë	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	-0,1	-0,5	0,3	0,0	-0,3	0,0	0,3	0,4	0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,2	1,3	0,0	0,0	-0,1	0,0	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,1	-0,2	0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,2	-0,1	0,0	0,2	1,1	-0,1	0,0	-0,2	0,5	-0,4	0,2	0,0	0,2
6	Shëndeti	0,0	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,0
7	Transporti	0,6	0,0	-0,2	-2,2	-1,7	-0,7	-0,1	0,1	0,5	-0,2	-0,4	-0,3	0,2
8	Komunikimi	0,0	-0,2	0,0	-0,1	0,0	0,8	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	-0,1
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	-0,5	0,6	0,0	0,8	-0,4	0,8	-0,9	0,1	0,0	-0,2	0,3	-0,2
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,3	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,1	0,3	0,0	0,3	0,0	0,0	-0,1

METODOLOGJIA

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2018.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.